Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0917

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) si dhe nenit 29 dhe 31 të Rregullores të Punës së OSHP-së 01/2020 e amandamentuar me 09. 08. 2023, në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare dhe Isa Hasani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "ALFA.i" si dhe ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Ejona" SH.P.K., kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit, Mosekzekutimit të vendimit të OSHP-së të Komunës së Pejës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), lidhur me aktivitetin e prokurimit "Instalimi i ngrohjes dhe rregullimi i ndriçimit ne Palestrën e sporteve Karagaq ne Peje LOT 1 Instalimi i ngrohjes qendrore dhe ventilimit ne Palestrën Karagaq dhe Leshan LOT 2 Rregullimi i ndriçimit ne Palestrën e sporteve Karagaq" me numër të prokurimit 635-23-5904-5-1-1, me 12/01/2024, mori:

Vendim

1. **Aprovohen**,si të bazuara ankesat e OE "ALFA.i, me nr. 2023/0917 e datës 17/11/2023 dhe ankesa e OE "Ejona" Sh.P.K. me nr. 2023/0927 e datës 20/11/2023, kurse vendimi i AK Komuna e Pejës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Instalimi i ngrohjes dhe rregullimi i ndriçimit ne Palestrën e sporteve Karagaq ne Peje LOT 1 Instalimi i ngrohjes qendrore dhe ventilimit ne Palestrën Karagaq dhe Leshan LOT 2 Rregullimi i ndriçimit ne Palestrën e sporteve Karagaq" me numër të prokurimit 635-23-5904-5-1-1, anulohet dhe kthehet në **ri-vlerësim**.

2. Këto ankesa konsiderohen si çështje e gjykuar (Res Judicata) pasi që pretendimet ankimore janë të njëjta si në Vendimin PSh. nr. 2023/ 0565 i dates 20. 10. 2023 dhe vendimin Psh. nr.2023/0579 i datës 25.10.2023, ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, andaj keto raste konsiderohet si çështje e gjykuar "Res Judicata" konform legjislacionit ne fuqi.

3. **Urdhërohet** në afat prej 5 ditësh, AK që ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Meqenëse ankesat e OE-ve ankues aprovohen si të bazuara, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

5. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i

bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 09.06.2023, Komuna e Pejës , në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Instalimi i ngrohjes dhe rregullimi i ndriçimit ne Palestrën e sporteve Karagaq ne Peje LOT 1 Instalimi i ngrohjes qendrore dhe ventilimit ne Palestrën Karagaq dhe Leshan LOT 2 Rregullimi i ndriçimit ne Palestrën e sporteve Karagaq" me nr. të prokurimit: 635-23-5904-5-1-1 Ndërkaq me datën 26.07.2023 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK.

Për këtë procedurë të lartcekur të prokurimit janë marrë dy vendime nga paneli shqyrtues i OSHP-së: nr. 565/23 dhe nr. 579/23.

Lidhur me këto ankesa është vendosur që të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së për LOT 1 duke rekomanduar që lënda të kthehet në rivlerësim.

Me datën 02. 11. 2023 është publikuar raporti i rivlerësimit të AK-së dhe është anuluar aktiviteti i prokurimit.

Kundër këtij vendimi me datën 06.11.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim OE "Alfa.i" të cilën AK e ka refuzuar me datën 09. 11. 2023.

Poashtu kundër vendimit për anulim me datën 07.11.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim edhe operatori ekonomik "Ejona Sh.P.K" të cilën me datën 09. 11. 2023, AK e ka refuzuar.

Me datën 17.11.2023 OE "ALFA.i"- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0917, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Instalimi i ngrohjes dhe rregullimi i ndriçimit ne Palestrën e sporteve Karagaq ne Peje LOT 1 Instalimi i ngrohjes qendrore dhe ventilimit ne Palestren Karagaq dhe Leshan LOT 2 Rregullimi i ndriçimit ne Palestrën e sporteve Karagaq" me nr. të prokurimit: "635-23-5904-5-1-1".

Poashtu me datën 20.11.2023, ankesë ka parashtruar edhe OE "Ejona" Sh.P.K, me nr: 2023/0927,kundër anulimit të aktivitetit të sipërcituar të prokurimit.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar,

ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 25.08.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Pretendimet e operatorit ekonomik ankuesOE "Alfa.i", janë parashtruar si në vijim:

- *Pretendimi i parë (I), Ankuesi pretendon se:* "Gjate vlerësimit te ofertës se juaj nga komisioni i vlerësimit ka konstatuar se mik i përmbushni kriteret e kërkuara ne Dosjen e Tenderit dhe ne Njoftim për Kontratë, pasi qe te kushtet e përgjithshme te D. T është kërkuar qe stafi profesional te jen te certifikuar me certifikatë profesionale niveli IV (Instalim, ngrohje, kanalizim dhe ujësjellës), ndërsa juve ju mungon Certifikata Profesionale e stafit teknik si dhe ju mungon diplomat te noterizuar për pjesën e stafit teknik, Po ashtu te stafi profesional te Inxhinierëve mungon Certifikata për mbrojtje nga zjarri si dhe te ju ne ofertën e juaj nuk keni plotësuar Aneksi - 7 te vendosur nga AK ne DT ku është kërkuar te plotësohet dhe te nënshkruhet nga OE, ka qenë kusht administrative pasi qe është ANEKS i veçantë qe duhet plotësuar, andaj me këtë ju njoftojmë qe oferta juaj është e pa përgjegjshme dhe eliminoheni nga ky AP". Kërkesa për rishqyrtim nga ne ishte bërë me dt.31.07.2023, kurse Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim ishte dërguar me dt:04.08.2023. Ankesën e kishim dorëzuar me dt. 10.08.2023. Ekspertiza e ekspertit shqyrtues ishte lëshuar me dt.25.08.2023 me nr. 2023/0565. Vendimi i OSHP-së ishte lëshuar me dt.25.10.2023 Nr.2023/0565. Eksperti i OSHP-së në ekspertizën e tij të dt.25.08.2023 me nr. 2023/0565 kishte konstatuar se ankesa jonë ishte e bazuar dhe se ishim eliminuar pa të drejtë në këtë aktivitet të prokurimit. Po ashtu kishte konfirmuar përgjegjshmërinë e ofertës tonë dhe papërgjegjshmërinë e OE të rekomanduar për kontratë CTA SHPK. Po ashtu edhe paneli shqyrtues me vendimin Nr. 2023/0565 të dt.25.10.2023 kishte aprovuar ankesën tonë si të bazuar dhe lënda ishte kthyer në rivlerësim. Paneli shqyrtues ka mbështetur plotësisht konstatimet e ekspertit shqyrtues, i cili kishte konstatuar se ne jemi eliminuar padrejtësisht dhe kishte aprovuar të gjitha pretendimet tona ankimore edhe në raport me OE e rekomanduar për kontratë, e po ashtu edhe vetë përfaqësuesi i AK-së në seancë ishte pajtuar që lënda të kthehet në rivlerësim dhe që të bëhet vlerësimi i ofertave sipas nenit 59 dhe 72 të LPP-së. Pas rivlerësimit me dt.02.11.2023 është nxjerr njoftimi i dytë mbi vendimin e AK-së (B58) ku është anuluar ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se nuk ka ofertues të përgjegjshëm. Kurse ne jemi eliminuar me arsyetimin sepse: Gjate Ri- vlerësimit te ofertës se juaj nga komisioni i Ri -vlerësimit ka konstatuar qe ne ofertën e juaj nuk e plotësoni kriterin e kërkuar ne FDT , Pasi qe ju ne ofertën e juaj nuk keni plotësuar Aneksi - 7 te vendosur nga A.K ne D.T ku është kërkuar te plotësohet dhe te nënshkruhet nga OE për Afati i Implementimit dhe Periudha Garantuese, ka qenë kusht administrative pasi qe është ANEKS i veçante qe duhet plotësuar, andaj me këtë ju njoftojmë qe oferta juaj është e pa përgjegjshme dhe eliminoheni nga ky AP". Kjo arsye e eliminimit kishte qenë edhe njëra ndër arsyet e eliminimit në vlerësimin e parë, e ku eksperti shqyrtues dhe paneli shqyrtues ka konstatuar se edhe kjo arsye e eliminimit ka qenë e paqëndrueshme dhe e pabazuar. Në lidhje me këtë arsye të eliminimit, konfirmojmë se kjo pikë është trajtuar me vendim të OSHP-së dhe normalisht që konsiderohet çështje e gjykuar - Res Judicata sipas nenit 105 paragrafi 2.16 i LPP-së dhe duhet trajtuar si e tillë.
- Fillimisht ju sqarojmë se plotësimi i aneksit 7 nuk ka qenë kërkesë e kualifikueshmërisë (nuk ka qenë kërkesë e FDT-së) ashtu siç është cekur në ekspertizë të ekspertit shqyrtues, mirëpo pavarësisht këtij fakti, ne kemi ofruar dëshmi-deklaratën garantuese në një dokument të veçantë, e po ashtu kemi ofruar edhe planin dinamik me afat të implementimit, prandaj plotësohet kërkesa në fjalë. Nga këto sqarime dhe dëshmi konkrete kuptohet qartë se nuk

është respektuar vendimi i panelit shqyrtues Nr. 2023/0565 i dt.25.10.2023, vendim. Po ashtu OE "CTA" Sh.p.k., (ish OE i rekomanduar për kontratë) është i papërgjegjshëm për arsyet si në vijim: Mungon Marrëveshjet e noterizuara me inxhinieret e makinerisë, Certifikata për mbrojtje nga zjarri për ing. Xhevat Berisha nuk është prezantuar sipas kërkesës, ku është kërkuar që e njëjta të jetë e noterizuar, mirëpo OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka prezantuar të noterizuar, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm. Për menaxherin z. Shaqir Elezaj Certifikata për Auditim te energjisë në ndërtesa është e pa noterizuar, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm. Po ashtu edhe marrëveshjet e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë për stafin teknik nuk janë te noterizuara siç është specifikuar në dosje të tenderit, njëkohësisht edhe Certifikatat e tyre nuk janë të noterizuara. Këto pretendime tona dhe konstatime, ishin konfirmuar edhe nga ekspertiza dhe vendimi i panelit shqyrtues Nr. 2023/0565. OE EJONA SHPK është i papërgjegjshëm me arsyet si në vijim: Është kërkuar qe te prezantohet katalogu i produkteve si ne vijim Katallogu, nga prodhuesi ose dileri për pozicionet Nr Cl, C2, D1 &D2 si dëshmi Kopja e Katalogut nga prodhuesi ose dileri, kurse ka dorëzuar katalogun e prodhuesit ku te pozicioni C1 ne Specfikimi Teknik te A.K është kërkuar qe kapaciteti i ngrohjes te jete 140 kë. Ndërsa ne katalog është prezantuar kapaciteti i ngrohjes te jetë 138 kë. Po ashtu nuk e ka të vulosur Aneksin 1 te Specifikimit Teknik te Dosjes se Tenderit si dhe ky kapacitet nuk i përmbush Specfikimin Teknik, prandaj duke ju referuar Udhëzuesit Nr. 001/2023 Për Prokurimin Publik nenit 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve Thuhet qartë si ne vijim. Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara -i Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm Sipas Nenit 69 te LPP-së Ne me dt.09.11.2023 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo nuk janë dhënë fakte dhe dëshmi konkrete për një refuzim të tillë. Autoriteti kontraktues në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim sa i përket arsyes së eliminimit tonë ka dhënë arsyetimin e njëjtë sikurse në njoftimin mbi vendimin e AK-së. Ky arsyetim i AK-së e tregon qartë faktin se pretendimet tona janë të qëndrueshme, dhe AK- ja nuk ka argumente për të kundërshtuar me fakte konkrete këto pretendime.

- Ne jemi OE i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit dhe ky fakt është vërtetuar edhe nga eksperti shqyrtues dhe paneli shqyrtues i OSHP-së, mirëpo AK-ja me arsyetime krejtësisht të pa bazuara, kundërligjore dhe subjektive na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit. Autoriteti kontraktues duke e kuptuar se nuk mundet në asnjë mënyrë të na eliminoj nga ky aktivitet i prokurimit dhe se nuk mundet ta anulojë këtë tender, tani ka nxjerr një arsyetim tjetër në vendimin për refuzim duke u arsyetuar se AK-ja nuk mund ti ketë në dispozicion mjetet e garantit qeveritar prej 250,000.00 euro, për vitin 2023. Nga ky arsyetim shihe qartë tendenca e AK-së që ne si OE i përgjegjshëm të mos nënshkruajmë kontratën, pasi që në njoftimin mbi vendimin e AK-së nuk ka qenë një arsyetim i tillë, mirëpo me qëllim që ne të mos nënshkruajmë kontratën tani AK-ja nxjerr një arsyetim të tillë. Duke u bazuar në faktet e lartcekura kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm, për më tepër tendencioz kundrejt kompanisë tonë si OE i përgjegjshëm. Nga dëshmitë dhe provat të cilat u cekën në këtë ankesë rezulton se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe me nenin 43.5 dhe 43.7 të Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik. Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse ne jemi diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente". Gjatë zhvillimit të kësaj procedure nuk është marr në konsideratë

edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankuesOE "Ejona SHPK", janë parashtruar si në vijim:

- *Pretendimi i parë (I):* Neni 97-Mos respektimi i vendimeve të OSHP-së dhe KRPP-së AK shkel nenin e lartpërmendur duke mos respektuar vendimin e shpallur nga OSHP qe te ktheje lenden ne rivlerësim. Pra, AK nuk e kthen fare lenden ne rivlerësim, mirëpo shpall vendimin për anulimin e aktivitetit te prokurimit me te njëjtat pretendime te cilat OSHP i ka cilësuar si te pabazuara me datën 25.10.2023. Kjo është një shkelje tjetër e rende te cilën AK vendose ta beje, nga pamundësia për te shpallur fitues OE favorit.
- *Pretendimi i dytë (II):* Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve - AK shkel nenet e lartpërmendura duke përsëritur shkeljet e bëra edhe ne vlerësimin e pare. AK vendose qe përsëri te na eliminoje nga gara, kësaj radhe me kërkesa te cilat nuk kane qene ne DT dhe as ne Njoftimin për Kontratë. Pra, AK na eliminon me pretendimin se ne nuk kemi nënshkruar dhe vulosur Aneksin e specifikimeve teknike, ani se kjo nuk ishte fare kërkesë ne DT. Poashtu, ne kemi dorëzuar Deklaratën për specifikime teknike e cila mbulon këtë kërkesë edhe po te ishte ne DT. - AK na eliminon me pretendimin e dyte se produkti i ofruar nga ne nuk plotëson kërkesat teknike dhe ky pretendim nuk qëndron. Pasi qe për këtë pretendim AK ka edhe vendimin e OSHP-se i cili e hedh këtë pretendim te AK-se si te pabazuar. Ku AK është dashur te kërkoj sqarime (edhe pse këto sqarime ne i kemi dorëzuar gjate kërkesave për rishqyrtim dhe seancës ne OSHP). Ne përsëri po e bashkëngjisim specifikimin teknik te chilerit (te njëjtin e kemi prezantuar edhe ne OSHP), ku shihet qarte se chileri i ofertuar nga ne përmbush te gjitha kërkesat teknike.
- *Pretendimi i tretë (III):* Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi AK vazhdimisht ka shkelur Nenin e lartpërmendur duke bere diskimin për ne dhe favorizim për OE te shpallur njëherë fitues "CTA" Sh.P.K. AK tentoje qe te shpalle fitues OE te lartpërmendur i cili kishte ofruar çmimin me te larte, duke eliminuar dy OE dhe duke nxjerrë vendime te pabazuara. Këtë vendim e quajti te pabazuar edhe OSHP me vendimin e tyre me datën 25.10.2023 dhe OSHP vendosi qe te ktheje lenden ne rivlerësim, duke i kërkuar AK-se qe te beje kërkesë për sqarim lidhur me specifikimin teknik dhe dokumentet qe i ka te paqarta. AK nga pamundësia qe te shpalle fitues OE favorit, vendose qe te anuloje ne tërësi aktivitetin e prokurimit duke shpallur edhe njëherë vendim te pabazuar. Pra, AK tenton qe me çdo kusht te shpërbleje OE ne fjale duke mos marre ne konsiderate LPP, ne te kundërshton anulon ne tërësi aktivitetin.
- *Pretendimi i katërt (IV):* AK ka shkelur Nenet e lartpërmendura për arsye: AK publikon refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim duke mos shqyrtuar pretendimet tona fare, mirëpo ne refuzimin e kërkesës për rishqyrtim vetëm ka përsëritur pretendimet si ne letrën e eliminimit. Pra është hera e dyte qe AK nuk shqyrton fare kërkesën tone për rishqyrtim dhe nuk arsyeton refuzimin ashtu siç e thotë LPP.

Lidhur me pretendimet e OE "Alfa. i" eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0917 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim për Panelin Shqyrtues: Autoriteti Kontraktues Komuna e Pejës, ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit me titull: "Instalimi i ngrohjes dhe rregullimi i ndriçimit ne Palestrën e sporteve Karagaq ne Peje LOT 1 Instalimi i ngrohjes qendrore dhe ventilimit ne Palestrën Karagaq dhe Leshan LOT 2 Rregullimi i ndriçimit ne Palestrën e sporteve Karagaq", me numër të prokurimit: 635-23-5904-5-1-1, procedurë e hapur, lloji i kontratës: Punë, vlera e parashikuar e

kontratës: 590,870.72 €.Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë me datën 09.06.2023, Ndërsa, me datë 15.06.2023 dhe 07.07.2023 ka publikuar B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve.Me datë 26.07.2023 AK ka nxjerrë Njoftimin mbi Vendimin e AK-së. OE ankues "ALFA.I Sh.P.K" me datë 31.07.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, kundër Vendimit të AK-së, ndërsa AK me datë 04.08.2023 ka nxjerrë Vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, rrjedhimisht kundër këtij Vendimi të AK-së, OE ankues "ALFA.I SH.P.K" me datë 10.08.2023 , ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së.Eksperti shqyrtues i prokurimit, sipas autorizimit 2023/0565, dhe në pajtim me nenin 114 të LPP-së, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave, shkresave të lëndës në platformën elektronike e-prokurim, lidhur me të gjeturat dhe konstatimet, Eksperti shqyrtues i prokurimit ka dorëzuar Raportin e Ekspertizës me datë 25.08.2023 me nr.2023/0565, si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues me datë 25.10.2023 ka nxjerr Vendim për ankesën me Nr. 2023/0565.Gjithashtu, Eksperti shqyrtues i prokurimit, sipas autorizimit 2023/0917, i paraqet këto të gjetura dhe konstatime si në vijim:Autoriteti Kontraktues Komuna e Pejës, këtë aktivitet të prokurimit e ka kthyer lëndën në Ri-vlerësim, dhe pas Ri-vlerësimit të ofertave, me datë 02.11.2023 ka nxjerr njoftimin mbi vendimin e AK-së, me arsyetimin se "*Komuna e Pejës Anulon Lot 1 pasi qe as një ofertë nuk ka qene e përgjegjshme".*Ndërsa, OE ankues "ALFA.I Sh.P.K", kundër vendimit të AK-së, me datë 06.11.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, dhe me datë 17.11.2023, ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së.Sa i përket pretendimeve ankimore të OE ankues, të paraqitura në ankesën 2023/0917 për këtë aktivitet të prokurimit, Eksperti shqyrtues këto pretendime ankimore nuk i ka shqyrtuar, për faktin se, të njëjtat pretendime ankimore janë shqyrtuar në lëndën me Nr. 2023/0565, andaj duke u bazuar në paragrafin 2 dhe 3 të nenit 16 të Rregullores së Punës të OSHP-së, duke qenë se pretendimet ankimore janë të njëjta të cilat janë shqyrtuar më parë nga Paneli Shqyrtues, kjo çështje trajtohet si çështje e gjykuar "res judicata".

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtuese, ndërsa OE nuk është deklaruar për raportin e ekspertit shqyrtues.

Lidhur me pretendimet e OE "Ejona Sh.P.K" eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0927 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim për Panelin Shqyrtues: Autoriteti Kontraktues Komuna e Pejës, ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit me titull: **"**Instalimi i ngrohjes dhe rregullimi i ndriçimi ne Palestrën e sporteve Karagaq ne Peje LOT 1 Instalimi i ngrohjes qendrore dhe ventilimit ne Palestrën Karagaq dhe Leshan LOT 2 Rregullimi i ndriçimit ne Palestrën e sporteve Karagaq**",** me numër të prokurimit: 635-23-5904-5-1-1, procedurë e hapur, lloji i kontratës: Punë, vlera e parashikuar e kontratës: 590,870.72 €.Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë me datën 09.06.2023, Ndërsa, me datë 15.06.2023 dhe 07.07.2023 ka publikuar B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve.Me datë 26.07.2023 AK ka nxjerrë Njoftimin mbi Vendimin e AK-së. OE ankues "Ejona SH.P.K." me datë 31.07.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, kundër Vendimit të AK-së, ndërsa AK me datë 04.08.2023 ka nxjerrë Vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, rrjedhimisht kundër këtij Vendimi të AK-së, OE ankues "Ejona SH.P.K." me datë 14.08.2023 , ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së.Eksperti shqyrtues i prokurimit, sipas autorizimit 2023/0579, dhe në pajtim me nenin 114 të LPP-së, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave, shkresave të lëndës në platformën elektronike e-prokurim, lidhur me të gjeturat dhe konstatimet, Eksperti shqyrtues i prokurimit ka dorëzuar Raportin e Ekspertizës me

datë 28.08.2023 me nr.2023/0579, si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues me datë 25.10.2023 ka nxjerr Vendim për ankesën me Nr. 2023/0759.Gjithashtu, Eksperti shqyrtues i prokurimit, sipas autorizimit 2023/0927, i paraqet këto të gjetura dhe konstatime si në vijim:Autoriteti Kontraktues Komuna e Pejës, këtë aktivitet të prokurimit e ka kthyer lëndën në Ri-vlerësim, dhe pas Ri-vlerësimit të ofertave, me datë 02.11.2023 ka nxjerr njoftimin mbi vendimin e AK-së, me arsyetimin se, "*Komuna e Pejës Anulon Lot 1 pasi qe as një ofertë nuk ka qene e përgjegjshme".* Ndërsa, OE ankues "Ejona Sh.P.K.", kundër vendimit të AK-së, me datë 07.11.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, dhe me datë 20.11.2023, ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së. Sa i përket pretendimeve ankimore të OE ankues, të paraqitura në ankesën 2023/0927 për këtë aktivitet të prokurimit, Eksperti shqyrtues këto pretendime ankimore nuk i ka shqyrtuar, për faktin se, të njëjtat pretendime ankimore janë shqyrtuar në lëndën me Nr. 2023/0579, andaj duke u bazuar në paragrafin 2 dhe 3 të nenit 16 të Rregullores së Punës të OSHP-së, duke qenë se pretendimet ankimore janë të njëjta të cilat janë shqyrtuar më parë nga Paneli Shqyrtues, kjo çështje trajtohet si çështje e gjykuar "res judicata".

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtuese, ndërsa OE ka deklaruar se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës ka gjetur se ankesat duhet të aprovohen si te bazuara. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të obliguar AK që të kthej aktivitetin e prokurimit në Rivlerësim, pasi që konsiderohet se AK nuk ka vepruar konform dispozitave ligjore dhe rekomandimeve të dhëna me vendimet paraprake të OSHP të datës 25.10.2023 me Nr. 2023/0565, si dhe me vendimin e datës **25.10.2023** me Nr. **2023/0579,** është kthyer aktiviteti në rivlerësim, andaj, meqenëse ankesat e OE ankues përsëriten për herë të dytë konform Rregullores së Punës se OSHP-së konkretisht neni 16.2 te trajtohet si "Res Judicata". Po ashtu neni 105 paragrafi 2.16 i LPP-së sqaron: "Në rastet e përsëritura me të njëjtat pretendime ankimore, ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, në rastet të cilat janë shqyrtuar më parë, Kryetari i Panelit Shqyrtues i trajton si çështje të gjykuara "res judicata".

Në bazë të sqarimeve të lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozojnë panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në Rivlerësim.

Pas analizimit të shkresave të lartpërmendura të cilat i kishte në dispozicion Paneli Shqyrtues, si: Ankesat e OE ankues, raportet e ekspertit shqyrtues, vendimet paraprake të OSHP lidhur për këtë aktivitet të prokurimit, dihet mirë se vendimet e OSHP-së janë të detyrueshme për autoritetet kontraktuese dhe të gjitha palët në procedurë, dhe se kundër vendimeve të OSHP-së, palët mund të ankohen në gjykatën kompetente brenda afatit ligjor me mjete të rregullta juridike, në përputhje me këshillën juridike të dhënë në vendim.

Andaj, Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna e Pejës që në tërësi të zbatohen vendimet e lartëcekura të OSHP. OSHP-ja urdhëron Autoritetin Kontraktues (AK) - Komuna e Pejës që të ndërmarr masa për zbatimin e vendimit të lartpërmendur në afat prej pesë (5) ditësh, mos respektimi i këtij urdhri, në afat prej pesë ditësh kalendarike, do ta detyrojë panelin shqyrtues që të respektoj nenin 131 të LPP-së dhe njëkohësisht do të kërkojë nga KRPP-ja që ti anulojë licencën menaxherit të prokurimit të Autoritetit Kontraktues (AK) - Komuna e Pejës në pajtim me nenin 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Lidhur me tarifën ankimore është vendosur konform nenit 31 paragrafi 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA E PEJES, KOMUNA E PEJES**
- OE - **ALFA.i, " EJONA " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: